

AKT THEMELUES

I SHOQERISE TREGTARE PRIVATE

“FALKAT 22” SH.P.K.

Unë Arben Mlika, i biri i Bajramit, dtl 01.01.1971, banues ne Rruga e Dibres ,Kompleksi Halili, Kulla B Ap 19,Tirane

Dhe

Unë Frans Gjillani, i biri i Ganiut, dtl 26.04.1985, banues ne Rruga e Dibres. Vila 741 Tirane

Mbështetur në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit ” dhe në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ”, sot më datë 24.01.2022, krijojme shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “FALKAT 22 ”, me aktin themelues të saj si vijon :

FORMIMI

NENI 1

Formohet shoqëria private e quajtur “FALKAT 22” sh.p.k. Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaku themelues.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Selia e shoqërise tregtare private “FALKAT 22” sh.p.k. do të jetë :
Njesia bashkiake Nr 9, Rr Papa Kristo Negovani, Pallati LIM-EM, Kati 2 Hyrja 2/6,Tirane

Ajo mund te çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci oprative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim të organve kompetente edhe jashtë vendit.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e ortakut themelues të saj.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 3

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në fushën e:

1. Tregtimit dhe import-eksport të Atoveturave, Automjeteve dhe makinerive te ndryshme.
2. Dhenie me qera te autoveturave, motorrave dhe automjeteve te tjera.
3. Servis per te gjitha llojet e automjeteve
4. Tregtimit dhe import-eksport të :

Pjesë këmbimi për makina, lubrifikante, vajra makinash, pjese elektrike dhe kompjuterike per automjete, pjesë këmbimi për te gjitha llojet e automjeteve.

NENI 4

Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të sigurojë mjetet e nevojshme dhe do të bashkëpunojë me persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkaku.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare private “FALKAT 22” sh.p.k. do të jetë **100** (Nje qind) lekë dhe do të përbëhet nga kuotat e ortakeve themelues të shoqërisë. Kapitali përbëhet nga **2** kuota dhe vlera nominale e një kuote është e barabartë me **50** lekë.

Z. Arben Mlika zotron 1 kuote me vlerë 50 leke qe perbene 50% te kapitalit themeltar
Z. Frans Gjillani zotron 1 kuote me vlerë 50 leke qe perbene 50% te kapitalit themeltar

Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet sipas vendimit të ortakeve themelues. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

NENI 7

Ortaku i vetëm duhet të bëjë përpjekje për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajë sekretin e saj dhe të mos dëmtojë interesat e personave të tjera dhe të shoqërisë.

DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 8

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, Z. Frans Gjillani, i cili është përfaqësues ligjore i saj. Afati i emërimit të administratorit është për një periudhë kohore prej **5** vjet me të drejtë ripërtëritje.

NENI 9

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakut themelues të shoqërisë.

NENI 10

Ortaku themelues ka të drejtë të emërojë dhe administratorë të tjera të vlerave materiale të shoqërisë. Ai ka të drejtë të caktoje financier, likuidator për problemet e shoqërisë, si edhe të pajtojë persona të tjera si ortakë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer të shoqërisë.

NENI 11

Konfliktet që mund të lindin midis palëve do të gjykohen dhe zgjidhen në zbatim të legjislacionit shqiptar në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 12

Shoqëria ka vulën e saj në madhësi të zakonshme, me tekstin për rrithin e saj.

NENI 13

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

NENI 14

Ky akt themelimi përpilohet në tre kopje me vlerë të barabartë, nga të cilat njëra depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, njëra në zyrën e Tatimeve dhe kopja e tretë mbahet në dokumentat e shoqërisë tregtare


"FALKAT 22" sh.p.k.

Akti i themelimit nenshkrum rregullisht nga ortaket themelues.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

"FALKAT 22" sh.p.k

ARBEN MLIKA



FRANS GJILLANI

